



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I. Numër: 400-01/74424, datë: 27 Shtator 2024.**

Në bazë të nenit 12.pika 2 (d), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 datë: 04.Qershor 200”) nenit 20 paragrafi 1, pika 1.4. dhe nenit 84. paragrafi 1, pika 1.4. të Statutit të Komunes së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 27 Shtator 2024, pas shqyrtimit të Draft Rregullore për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës, 2024-2026, në Komunën e Pejës, merr:

**VENDIM  
Nr. 57/2024**

**Mbi miratimin në parim për dhënie në diskutim publik të Draft Rregullore për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës**

- I. IPET në Diskutim Publik: Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
- II. Diskutimi Publik zgjat 14 ditë, nga dita e shpalljes – paraqitjes së Draft Rregullore për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës në Tabelen e shpalljeve publike dhe në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.
- III. Qytetarët e interesuar mund të njoftohen me tekstin – përmbajtjen e Draft – Planit të lartë cekur, përmes Drejtorisë Për Punë Komunale dhe Sherbime Publike (DPKSHP) të Komunës së Pejës.
- IV. Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës, mund të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen përmes Zyrës së pranimi – Arkives, për DPKSHP të Komunës së Pejës, si dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.
- V. Vërejtjet dhe sugjerimet duhet të paraqiten vetëm me shkrim dhe në kohën e afatin caktuar me këtë vendim, ngase vërejtjet e paraqitura jashtë afatit nuk do të mirrën parasysh.

**KRYESUESI I KUVENDIT,  
Rexhep Kurtbogaj**



Vendimi ti dërgohet:

- 1x1. DPKSHP,
- 1x1. Arkivë.